

...duke ndihmuar në realizimin e ëndërrave...

THE BISLIMI GROUP

...helping make dreams come true...

PROGRAMI I BURSAVE ARSIMIM PER PAQE

KUMTESE PER SHYTP

17 Dhjetor 2007

Kontakti: Halit Bislimi, 044 132 879, halit@bislimi.org

Nga aktiviteti i programit “Arsimim për Paqë” i Fondacionit “The Bislimi Group”

Vazhdon tradita e dhënjes së bursave për studime në Amerikë

Prishtinë, 17 Dhjetor 2007—Fondacioni “The Bislimi Group” i themeluar në vitin 2006 nga presidenti i saj z. Faton Bislimi, vazhdon traditën për dhënjen e bursave për talentë nga Kosova që të studjojnë në Amerikë, konkretisht në një nga universitetet më prestigjioze në Amerikë, në Texas Lutheran Universiti (TLU).

Sikurse edhe vitin e kaluar edhe këtë vit u ndanë bursat sipas projektit të paraparë dhe sipas kritereve të parapara e që janë mjaftë rigoroze. Studentët përfitues para pak ditësh janë paisur edhe me vizat studentore të marra në Ambasadën Amerikane në Shkup. Përfituesit e bursave janë kualifikuar nga një konkurrencë shumë e fortë akademike. Njëri prej tyre është nxënësi i shpallur nga MASHT, maturanti më i mirë në Kosovë i vitit akademik 2006/07, ne testin e pjekurisë me 100% poena, z. Valmir Buçaj nga komuna e Malishevës. Kur jemi tek komuna e Malishevës, diçka duhet të fusim në korniza të trasha.

Komuna e Malishevës, në radhë të parë kryetari i Komunës së Malishevës, z. Gani Krasniqi, por edhe stafi tjetër i tij e kanë kuptuar më së miri në Kosovë se cili është investimi më i mirë afatgjatë, dhe janë shembulli më i mirë në Kosovë se si duhet ndihmuar të rinjtë (talentët e rinjë) për të ndihmuar komunën e vetë dhe Kosovën për të ardhmën. Ata pa u hamendur iu kanë përgjigjur një ftese të fondacionit për ta ndihmuar Valmirin për t’u shkolluar në Amerikë, ashtu që ai të jetë një kuadër i efektshëm dhe profesional për Malishevën dhe për Kosovën, dhe i kanë ndarë 7.000 € ndihmë për këtë qëllim, ku gjysmen e mjeteve veq i kanë derdhur ne fondin e fondacionit. Me këtë rast i falenderojmë publikisht.

Nxënësit dhe studentët konkurues kanë qenë nga të gjitha trojet e Kosovës, si dhe nga shkollat publike dhe ato private.

Kriteret për të qenë përfitues i bursës kanë qenë mjaftë të forta në aspektin e njohurive akademike, njohjes se gjuhës angleze, aftësive të larta talentuese, etj.

Numri i bursave ka qenë i kufizuar, dhe, edhe pse shumë konkurues tjerë do ta meritonin bursën po të kishte mundësi më të mëdha, ata për fat të keq janë refuzuar.

Tani më fondacioni “The Bislimi Group”, duke patur eksperiencen nga viti i kaluar, ka përzgjedhur talentët nga Kosova, dhe ata kanë marrë vizat studentore për të shkuar në Amerikë, dhe udhëtimi i tyre do të ndodhë me 12 Janar 2008, për të arritë me kohë për semestrin dimëror.

Presidenti i fondacionit “The Bislimi Group” z. Faton Bislimi, shprehet të jetë i kënaqur me grupin e bursistëve të vitit të kaluar, të cilët kanë arritë suksese të shkelqyera në studime dhe dy prej tyre tani janë anëtarë të programit “Studenti i Nderit”, ku mund të bëhen antarë vetëm ata studentë që mbarojnë vitin me dhjetshe.

Gjithashtu, ai beson se edhe këtë vit studentët bursistë të të tij, do të kenë të njejtat suksese, dhe ndoshta edhe më të mëdha, sepse talenti nuk iu mungon.

Talentët kosovarë kanë patur mundësi të konkurimit në bazë të kritetreve të caktuara nga fondacioni për programin e bursave “Arsimim për Paqe” në një afat të mjaftuar kohor dhe nga një informim i gjërë përmes mediave të shkruara dhe elektronike të Kosovës. Bursat ndahen për katër vite, normalisht, nëse studenti nuk humb kriteret e nevojshme për bursë.

Për vitin akademik 2007/08 përfitues të bursave janë:

- Valmir Buçaj, i shpallur nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, maturanti më i mirë i Kosovës për vitin 2007. Valmiri ka mbaruar gjimnazin në Malishevë me sukses të shkelqyeshëm dhe është njohës i mirë i anglishtes. Valmiri është djalë dëshmori.
- Drilona Aliu, ka mbaruar tri vitet e para të shkollës së mesme i ka mbaruar në shkollën Amerikane në Kosovë, ndërsa vitin e katërtë e ka mbaruar në ShBA, konkretisht në Guilderland High School, New York. Është njohëse e mirë e anglishtes.
- Teuta Hyseni ka mbaruar me suksese të shkelqyeshëm gjimnazin “Zenel Hajdini” në Gjilan, ka patur aktivitete jashtë shkollore dhe është njohëse e mirë e gjuhës angleze.

Kënaqësia është e papërshkruar kur ke të bëjshë me talentë të tillë, të cilët i kanë bërë një premtim moral presidentit të fondacionit, se pas përfundimit të studimeve ata do të kthehen të punojnë në Kosovë, për të ndihmuar ndërtimin e shtetit të ri, sidomos në aspektin arsimor, shoqëror, ekonomik dhe pse jo edhe politik.

Në këtë rast nuk duhet harruar të përmenden dhe të falenderohen të gjithë ata që i shkruajnë këtij fondacioni me fjalë të larta miradie, për punën e mirë që e bënë në arsimimin e të rinjëve kosovarë.

Ndërsa pos, presidentit të fondacionit z. Faton Bislimi, meritat më të mëdha në shkollimin e këtyre talentëve kosovarë i ka vet Universiteti TLU (Texas Lutheran University) nga Texasi, USA. Ky Universitet për këtë vit kontribon me mbi 120.000 \$, ndërsa për vitin e ardhshëm pritet që ai investim të jetë afër 200.000 \$.

Fondacioni “The Bislimi Group” për vitin akademik 2008/09, konkursin për dhënjen e bursave do ta shpallë kah mbarimi i prillit apo fillimi i majit 2008.